



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Datë:09.08.2024

Njësia e Burimeve Njerëzore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë neni 48 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe paragrafit 6, si dhe duke u bazuar në paragrafin 2 nën paragrafi 2.3 dhe paragrafit 3 dhe 4 të nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 05/2024 , me datë 09.08.2024 publikon këtë:

SHPALLJE PUBLIKE

Për pranimin e aplikimeve për një (1) ekspert i jashtëm për anëtarë të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese

1. Kandidatët për ekspert i jashtëm të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, në pajtim me dispozitat e nenit 23 paragrafit 2 , nën paragrafi 2.3 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:

- të kenë diplomë universitare të paktën 240 kredi.
- të kenë tetë (8) vite përvojë pune profesionale prej të cilave të paktën pesë (5) vite në pozita të nivelit drejtues;
- të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- të kenë integritet moral dhe profesional;
- të mos kenë aktakuzë të konfirmuar dhe të mos kenë qenë të dënuar për kryerjen e një vepre penale jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

2. Kandidatët për ekspert i jashtëm të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Biografinë (CV-në);
- Dëshminë e kualifikimit profesional (diplomën e fakultetit me të paktën 240 kredi). Për diplomat e pranuar jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;
- Dëshmitë për përvojën profesionale dhe përvojën menaxheriale në pozitat e nivelit drejtues;

- Deklaratën me shkrim që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga gjykata kompetente jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Deklaratën me shkrim që nuk është i punësuar në shërbimin civil, që nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe që nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- Kopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës (me afat të vlefshëm me rastin e aplikimit).

Kandidatët për ekspert i jashtëm për kategorinë e lartë drejtuese si personalitet i pavarur në Komisionin e Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, përfiton një pagesë fikse prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) Euro për procedurë të rekrutimit, në pajtim me dispozitat e nenit 23 paragrafit 4 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurat e Pranimit në Shërbimin Civil.

Afati për dorëzimin e CV-së, dhe dokumenteve përcjellëse sipas pikët 1 dhe 2 të kësaj thirrje publike për anëtar të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, është i hapur nga data 09/08/2024 deri më datë 16/08/2024 deri në ora 16:00.

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta.

Kandidatët e interesuar për aplikim për *ekspert i jashtëm për anëtarë të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese* dokumentet e bashkëngjitura mund t'i dërgojnë përmes postës elektronike në e-mail adresën: personeli.zkm@rks-gov.net;

Për informata shtesë mund të kontaktoni në nr. tel: 038 200 14 818 & 038 200 14 817 ose në email adresat: personeli.zkm@rks-gov.net